



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 19/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Nr. 3461/21H datë 27.10.2021 për akreditim të programeve të studimit:
 - Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 120 ECTS (akreditim)
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë (Nr. 3461/21H, datë 27.10.2021) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit: Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 120 ECTS.

Bazuar në pikën 1.2 të Nenit 10 të UA për Akreditim ku thuhet, “Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, KShC në mbledhjen e 94 të mbajtur më 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Universitet.

Për programin Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 120 ECTS (akreditim), institucioni ka paraparë si bartës të programit: Agron Pajaziti (PhD në Shkenca Teknike), Ferit Idrizi (PhD në Shkenca Teknike) dhe Beqir Hamidi (PhD në Shkenca Teknike).


Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se bartësit e këtij programi të studimit nuk plotësojnë kriterin e publikimeve shkencore sipas vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr. 3236/21D të datës 21.09.2021 për plotësim e parimeve themelore të Manualit për Akreditim, pika 5.1. e tij, ku përcaktohet se: *Nga 1 tetori 2021, përveç kritereve të përcaktuara me UA për akreditim, bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit në nivel BA/BSc duhet të kenë të paktën 1(një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë së paku 2 (dy) punime nga fusha e studimit/programit në revista shkencore të indeksuara si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCE koleksioni bërthamë (SCIE, SSCI dhe AHCI), apo 1.2 SCOPUS, duke përshtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHT.*

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të publikimeve nga stafi adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 120 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Pastaj ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hashija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

